



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.134

16 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.601, datë 12.9.2007	Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve, rregullave të licencimit, procedurave për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje licence, në fushën e shërbimeve turistike	3695
Vendim i KM nr.641, datë 3.10.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	3698
Vendim i KM nr.643, datë 3.10.2007	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit të detyrueshëm teknik të automjeteve rrugore dhe për caktimin e autoritetit kontraktues	3698
Vendim i KM nr.649, datë 29.9.2007	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike të shërbimit dhe të zakonshme	3699
Vendim i KM nr.650, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Thumanë të qarkut të Durrësit.....	3701
Vendim i KM nr.651, datë 29.9.2007	Një ndryshim në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.	3701
Vendim i ERE nr.55, datë 4.10.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.17, datë 19.12.2001 të Këshillit Drejtues të ERE-s “Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.....	3702
Vendim i ERE nr.56, datë 4.10.2007	Për miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.....	3703

Vendim i KKRT nr.595, datë 1.10.2007	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TELE JONI” ..	3704
Vendim i KKRT nr.596, datë 1.10.2007	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat vendor “TV PËRMETI”	3705
Vendim i KKRT nr.597, datë 1.10.2007	Për mosdhënie licence për televizionin vendor privat “TV INFO SHKODRA”	3705
Vendim i KKRT nr.598, datë 1.10.2007	Për mosdhënie licence për televizionin vendor privat “TV PARMA- SARALB”	3706
Vendim i KKRT nr.599, datë 1.10.2007	Për mosdhënie licence për radion vendore private “Radio Kiss” .	3706
Vendim i KKRT nr.605, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Scorpion”	3707
Vendim i KKRT nr.606, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Muzika Jonë”	3707
Vendim i KKRT nr.607, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Val’ e Kaltër” ..	3708
Vendim i KKRT nr.608, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Rash”	3708
Vendim i KKRT nr.609, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Energy” ..	3709
Vendim i KKRT nr.610, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Alpo”	3709
Vendim i KKRT nr.611, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Top Albania”	3710
Vendim i KKRT nr.612, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Klea”	3710
Vendim i KKRT nr.613, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “NEWS 24 TV”	3710
Vendim i KKRT nr.614, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV MARGIT”	3711
Vendim i KKRT nr.615, datë 1.10.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV SUPERSONIC”	3711
Vendim i KKRT nr.622, datë 1.10.2007	Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “Radio Magic”	3712
Vendim i KKRT nr.623, datë 1.10.2007	Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “Radio Planet”	3714
Vendim i KKRT nr.625, datë 1.10.2007	Mbi pavlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizive private	3715

VENDIM
Nr.601, datë 12.9.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE, RREGULLAVE TË
LICENCIMIT, PROCEDURAVE PËR APLIKIM, RIPËRTËRITJE, TRANSFERIM DHE
HEQJE LICENCE, NË FUSHËN E SHËRBIMEVE TURISTIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 28 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çdo person fizik a juridik, vendas ose i huaj, subjekt i këtij vendimi, për t’u pajisur me licencë/certifikatë, në fushën e shërbimeve turistike duhet të plotësojë standardet e mëposhtme:

a) Të ofrojë një shërbim cilësor dhe të garantojë zbatimin e rregullave e të parimeve të Kodit Global të Etikës në Turizëm;

b) Të ketë drejtuesin dhe një staf teknik profesional, me arsimin përkatës e të kualifikuar, në përputhje me objektin e veprimtarisë turistike;

c) Të ofrojë shërbim të paanshëm për të gjithë klientët, të cilët të jenë të gatshëm për ta konsumuar këtë shërbim, kundrejt pagesës, për të cilën është rënë dakord më parë;

ç) Të garantojë sigurinë e përgjegjësisë për dëmet, që mund t’u shkaktohen personave nga konsumimi i shërbimit, që ofron/ushtron subjekti;

d) Të plotësojë kushtet minimale për reklamimin e veprimtarisë dhe/ose të mjediseve të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga ministri përgjegjës për turizmin, në zbatim të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”;

dh) Të zbatojë në mënyrë të rreptë rregullat teknike, për masat e mbrojtjes nga zjarri;

e) Të plotësojë kushtet higjieno-sanitare gjatë veprimtarisë;

ë) Të sigurojë informacionet e nevojshme për shërbimet e ofruara, çmimet përkatëse, si dhe të paraqesë raportet, të dhënat e kërkuara nga strukturat shtetërore përkatëse, në bazë e për zbatim të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”;

f) Të plotësojë formularin tip të autodeklarimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Çdo person, fizik a juridik, vendas ose i huaj, subjekt i këtij vendimi, për t’u pajisur me licencë/certifikatë në fushën e turizmit duhet të paraqesë kërkesën, me shkrim, e cila duhet të shoqërohet edhe me:

a) Të dhënat për përfaqësuesin ligjor, adresën e saktë të selisë/filialeve, personin/at dhe numrat zyrtarë të kontaktit, e-mail-in etj.;

b) Vendimin e regjistrimit në gjykatë si person fizik/juridik, me objekt “Veprimtari turistike”, sipas fushës së veprimtarisë, që do të ushtrojë;

c) Certifikatën tatimore, në përputhje me objektin e veprimtarisë turistike;

ç) Diplomën a dëshminë, certifikatën individuale, si dhe çdo dokument tjetër, që provon kualifikimet përkatëse profesionale, në përputhje me funksionin drejtues dhe objektin e veprimtarisë turistike që drejton;

d) Dëshminë a diplomën, certifikatën individuale, si dhe çdo dokument tjetër, që provon kualifikimin përkatës, profesional të personelit operues për ato funksione apo shërbime që kryen;

dh) Nëpërmjet formularit të autodeklarimit të deklarojë lejet përkatëse, të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente, për masat e mbrojtjes nga zjarri, kushtet higjieno-sanitare të veprimtarisë turistike, mjetet e punës e patentat a autorizimet, që lidhen me llojin e veprimtarisë, që ushtron, në përputhje me rregulloret përkatëse, të miratuara nga ministri përgjegjës për turizmin;

e) Lejen e qëndrimit, për personat me shtetësi të huaj, e lëshuar nga autoritetet shtetërore kompetente, në bazë të ligjit për të huajt.

Dokumentet e kërkuara në origjinal të mbahen në dosje në selinë, ku ushtron veprimtarinë subjekti, dhe në Komisionin e Standardeve të Turizmit të dorëzohen fotokopje.

3. Procedurat e aplikimit për pajisjen me licencë/certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë turistike ndiqen e zbatohen nga Komisioni i Standardeve të Turizmit (më tej KST), i cili mbështetet

nga një sekretari teknike e caktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Subjektet, që kërkojnë të pajisen me licencë/certifikatë, i paraqesin kërkesë me shkrim ministrit përgjegjës për turizmin, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në përputhje me objektin e veprimtarisë, standardet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe në rregulloret përkatëse të nxjerra nga ministri përgjegjës për turizmin, në zbatim të neneve 31, 35, 36, 41, 42 e 45 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

5. Kërkesa e subjektit dhe dokumentacioni shoqërues i përcillen për shqyrtim KST-së, nëpërmjet sekretarisë teknike. Pasi verifikon dokumentacionin e paraqitur, sekretaria teknike njofton subjektin brenda 5 (pesë) ditëve pune për plotësimin e tij, nëse është i paplotë.

6. Pas plotësimit të dokumentacionit dhe verifikimit në vend të të dhënave të deklaruara e të depozituara në dosjen e subjektit, por jo më vonë se 15 ditë pune, sekretaria përgatit raportin vlerësues për Komisionin e Standardeve të Turizmit. Subjektit i njoftohet, me shkrim, fillimi i këtij afati, i cili vlerësohet si afati i dorëzimit zyrtar të dokumentacionit të plotë.

7. Komisioni i Standardeve të Turizmit shqyrton kërkesën e subjektit dhe raportin vlerësues, të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e dorëzimit, dhe i propozon ministrit përgjegjës për turizmin miratimin a refuzimin e licencës/certifikatës.

8. Ministri me urdhër të veçantë, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga data e dorëzimit të propozimit të KST-së, miraton a refuzon dhënien e licencës/certifikatës.

9. Procesi i licencimit/certifikimit duhet të përfundojë brenda 35 (tridhjetë e pesë) ditëve pune nga dorëzimi zyrtar i dokumentacionit. Kur kalon ky afat dhe subjekti nuk ka marrë njoftim, me shkrim, për kërkesën e tij, atëherë ai quhet i licencuar/certifikuar. Ministri përgjegjës për turizmin është i detyruar ta lëshojë licencën/certifikatën brenda tri ditëve pas përfundimit të këtij afati, në të kundërt subjektit i lind e drejta t’i drejtohet gjykatës.

10. Sekretaria teknike e KST-së, brenda 3 (tri) ditëve nga data e urdhrimit të ministrit për miratimin e licencave/certifikatave, njofton zyrtarisht dhe përgatit licencën/certifikatën, sipas standardeve dhe formateve të miratuara. Në rastin e refuzimit të kërkesës, po brenda këtij afati, subjektit i njoftohet, me shkrim, arsyeja e refuzimit.

11. Për marrjen e licencës/certifikatës bëhet një pagesë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë. Pagesa kryhet në numrin e llogarisë së Fondit të Zhvillimit të Turizmit, në zbatim të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

12. Afati i vlefshmërisë së licencës/certifikatës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit.

13. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit, kanë të drejtë ta ripërtërijnë licencën 40 (dyzet) ditë para përfundimit të afatit, duke iu nënshtruar të njëjtave standarde, kriteret dhe procedura, të përmendura më sipër, si dhe e dorëzojnë licencën/certifikatën origjinale, të mëparshme.

14. Licenca/certifikata individuale nuk mund t’i transferohet një individ tjetër, me përjashtim të rastit kur subjekti, që e përfiton licencën/certifikatën plotëson standardet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim e në rregulloret përkatëse, të miratuara nga ministri përgjegjës për turizmin.

15. Personit fizik a juridik, privat, të pajisur me licencë/certifikatë për të ushtruar një veprimtari turistike të caktuar, i hiqet licenca/certifikata nëse:

a) Provohet se nuk ka zbatuar më shumë se një herë Kodin Global të Etikës.

b) Nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për dhënien e informacioneve në Zyrën e Shërbimit të Turistëve dhe në strukturën përkatëse në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për paraqitjen e raporteve dhe të të dhënave statistikore, sipas rregullores për mbledhjen dhe përpunimin e tyre, dhe të formularëve, të miratuar në bazë të pikës 5 të nenit 34 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

Në këtë rast, subjekti njoftohet, me shkrim, që brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, të paraqesë informacionet, raportet dhe të dhënat statistikore të kërkuara. Nëse edhe pas këtij afati, subjekti nuk e përmbush këtë detyrim ligjor, strukturat e mësipërme i drejtohen, me një relacion KST-së, e cila më pas i propozon ministrit përgjegjës për turizmin nxjerrjen e urdhrimit për heqjen e licencës/certifikatës.

c) Subjekti kërkon ta mbyllë veprimtarinë turistike, për të cilën është pajisur me licencë/certifikatë. Në këtë rast, subjekti është i detyruar ta paraqesë kërkesën, me shkrim, te ministri përgjegjës për turizmin dhe ta kthejë licencën/certifikatën origjinale.

Pas heqjes së licencës/certifikatës, një kopje e urdhrimit të ministrit u njoftohet edhe organeve tatimore, ku subjekti ushtron veprimtarinë turistike.

16. Çdo subjekt, aplikues për licencë/certifikatë, ka të drejtën e ankimit te ministri përgjegjës për turizmin, në rast se shkelen procedurat dhe afatet e vendosura në këtë vendim, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

17. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Datë, më.....

FORMULAR TIP I AUTODEKLARIMIT

AUTODEKLARIM (do të përbëhet nga tre pjesë)

Institucioni (drejtuar institucionit për të cilin subjekti është i interesuar)

Pjesa e parë (do të përmbajë gjeneralitetet e përgjithshme)

Unë i nënshkruari.....deklaroj që jam banues në adresë.....me seli.....Tel.....cel.....dhe me dokument identifikimi/nr i pasaportës.....

Deklaroj se jam regjistruar në organet tatimore me nr.NIPT-i.....me vendim gjykate nr.....nuk jam në proces falimentimi, nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar (ndaj të tretëve) Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve (për subjektet juridike)

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.....dt..... “Për.....” (varet nga fusha për të cilën është i interesuar subjekti) dhe ndryshimet e tij, ligjin nr..... (nëse ka)

Pjesa e dytë (do të përmbajë informacion të përgjithshëm lidhur me aktivitetin që ka kryer më parë subjekti, me pyetje alternative) varet nga specifika e fushave ku vepron.

1. Keni licencë të mëparshme Po/jo
Nëse po specifikoni fushën.....

2. Keni oponencë projekti? Po/jo
Nëse po specifikoni këto të dhëna.....
1.
2.
3.

Pjesa e tretë (do të përmbajë përgjegjësinë e vetë subjektit në rast se ai nuk ka zbatuar apo ka dhënë informacion jo të saktë atëherë do të përballlet me ligjin në fuqi për raportim jo të saktë të të dhënave).

Deklaroj:

Që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VENDIM

Nr.641, datë 3.10.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, 14 e 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me

propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përbërja e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, për të gjitha kategoritë e nëpunësve të administratës doganore, ndryshohet, si më poshtë:

- “- Zëvendësministri i Financave, kryetar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave, anëtar;
- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave anëtar;
- Drejtori i personelit dhe shërbimeve mbështetëse në Ministrinë e Financave anëtar;
- Një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik anëtar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.643, datë 3.10.2007

PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË DETYRUESHËM TEKNIK TË AUTOMJETEVE RRUGORE DHE PËR CAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, shkronja “h”, 5, pika 3 dhe 9 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit të detyrueshëm teknik të automjeteve rrugore, në formën “Propozim i kërkuar”.

2. Autoriteti kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit të detyrueshëm teknik të automjeteve rrugore është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.649, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHETËTIT TË IZRAELIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe të zakonshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË SHETIT TË IZRAELIT DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Qeveria e Shtetit të Izraelit dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu quhen “Palët”);

me dëshirën për të zhvilluar më tej marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet të dy vendeve;

në përpjekje për të lehtësuar procedurat e udhëtimit për shtetasit e të dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të shërbimit ose të zakonshme, përjashtohen nga detyrimi për marrjen e vizës me qëllim hyrjen në territorin e Palës tjetër për një vizitë ose qëndrim që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes së parë.

Neni 2

Shtetasve të secilit vend, që kanë ndërmend të qëndrojnë në territorin e vendit tjetër për një periudhë që i kalon nëntëdhjetë (90) ditë, u kërkohet të pajisen paraprakisht me viza.

Neni 3

Shtetasve të secilit vend, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, që ushtrojnë funksione zyrtare në vendin tjetër si anëtarë të një personeli diplomatik ose konsullor me qëndrim në territorin e Palës tjetër dhe të afërmeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre, u kërkohet të pajisen me vizë tridhjetë (30) ditë nga data e hyrjes. Vizat e përmendura në këtë nen janë të vlefshme për periudhën e caktimit të tyre.

Neni 4

Vizat e përmendura në nenet 2-3 të kësaj Marrëveshjeje lëshohen falas nga misioni diplomatik ose konsullor i vendit përkatës.

Neni 5

Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme, kuptohet që qytetarët shqiptarë që hyjnë në Izrael dhe qytetarët izraelitë që hyjnë në Shqipëri nuk janë të përjashtuar nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregulloret e brendshme në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin apo profesionin për të huajt.

Neni 6

Secila Palë rezervon të drejtën të mos lejojë hyrjen për shtetasit e Palës tjetër, që ajo mund t'i konsiderojë të padëshirueshëm apo të shkurtojë periudhën e qëndrimit për këta shtetas.

Neni 7

1. Palët shkëmbejnë ekzemplarë të pasaportave të tyre të vlefshme nëpërmjet kanaleve diplomatike jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë lëshon një model të ri të një pasaporte apo modifikon ato që janë shkëmbyer, Pala tjetër njoftohet për këto modifikime nëpërmjet kanaleve diplomatike tridhjetë (30) ditë para datës së hyrjes në fuqi të pasaportave të reja apo të modifikimeve. Njoftimi përfshin një ekzemplar të dokumenteve të reja apo të modifikuara dhe informacionin për zbatueshmërinë e tyre.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi për një periudhë fillestare prej një viti, nëntëdhjetë (90) ditë nga data e notës së dytë të notave diplomatike nëpërmjet të cilave Palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë respektuar. Kjo Marrëveshje zgjatet automatikisht për periudha shtesë prej një viti secila.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa një Palë njofton tjetrën nëpërmjet një note diplomatike në lidhje me synimin e saj për ta përfunduar atë, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para datës së përfundimit të synuar.

Neni 9

Shkëmbimi i notave i datës 28 nëntor 1993, që përbëjnë një Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Izraelit dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me heqjen e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Nënshkruar në _____, më _____ 2007, që përputhet me ditën ____ 5767, në hebraisht, shqip dhe anglisht, ku të gjithë tekstet janë njëllëj autentikë. Në rast mospërputhjeje në interpretim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr.650, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN THUMANË TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Thumanë të qarkut të Durrësit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 929 (nëntëqind e njëzet e nëntë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.651, datë 29.9.2007

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.825, DATË 28.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave, në listën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave z.Kostandin Kazanxhi zëvendësohet me z.Flojran Nuri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.55, datë 4.10.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.17, DATË 19.12.2001 TË
KËSHILLIT DREJTUES TË ERE-S “PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI FURNIZIMIN
ME ENERGJI ELEKTRIKE TË PËRDORUESVE TË RINJ”

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit nr.38, datë 5.7.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për rishikimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.10.2007 pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria Jurdike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.17, datë 19.12.2001 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

A. Pikat 7.10 dhe 7.11 ndryshohen si më poshtë:

7.10 – Furnizuesi është i detyruar që brenda një muaji nga marrja e kërkesës për furnizimin me energji elektrike të përdoruesve familjarë dhe jofamiljarë të lidhur në TU, dhe dy muaj nga marrja e kërkesës për përdoruesit jofamiljarë në TM, të japë përgjigje me shkrim për miratimin dhe mënyrën e zgjidhjes.

7.11 - Lidhja e objektit me energji elektrike do të përfundojë në afatin e përcaktuar ndërmjet furnizuesit dhe përdoruesit sipas pikës D të aktmarrëveshjes paraprake ndërmjet palëve. Në çdo rast lidhja e objektit me energji elektrike e përdoruesit familjar dhe jofamiljar të lidhur në TU, do të përfundojë brenda 30 ditëve nga miratimi i kërkesës për furnizimin me energji elektrike dhe jo më vonë se 60 ditë në rastin e përdoruesit jofamiljarë të lidhur në TM.

B. Në udhëzimin për furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj shtohet kapitulli 8 me përmbajtjen :

Kapitulli 8 – Rilidhja me energji elektrike

8.1 Tarifa e rilidhjes me energji elektrike për klientët që u është ndërprerë furnizimi me energji elektrike, për shkak të debisë apo për shkelje të kontratës së furnizimit me energji elektrike e përcaktuar nga ERE do të jetë:

500 lekë - Për klientët familjarë;
1000 lekë – Për klientët jofamiljarë të furnizuar në TU;
5000 lekë – Për klientët jofamiljarë të furnizuar në TM.

8.2 Me propozim të KESH, ose me iniciativën e vet, në varësi të ndryshimeve që pëson kosto, sipas kategorisë së klientit, ERE rishikon tarifat e rilidhjes.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.56, datë 4.10.007

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LEHTËSIMIN E HYRJES NË RRJET TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME KAPACITET TË PËRGJITHSHËM JO MË TË MADH SE 5 MW

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 dhe 42, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.50, datë 24.8.2007 “Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 4.10.2007,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW (bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLORE E LEHTËSIMIT TË HYRJES NË RRJET TË CENTRALEVE TË RINJ ELEKTRIKË ME KAPACITET TË PËRGJITHSHËM JO MË TË MADH SE 5 MW

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 42, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 2
Qëllimi

Të sigurojë procedura të thjeshtuara për hyrjen në rrjet të centraleve të rinj elektrikë me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.

Neni 3
Zbatimi

Kjo rregullore aplikohet për të gjithë të licencuarit që ndërtojnë dhe fusin në shfrytëzim centrale të prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet jo më të madh se 5 MW, të cilët kërkojnë të realizojnë hyrjen në rrjet të centralit/eve.

Neni 4
Përcaktime

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. ERE do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, i cili është institucioni rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
2. Bordi i Komisionerëve është organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.
3. I licencuar është personi mbajtës i një autorizimi të dhënë nga ERE për të operuar në prodhimin e energjisë elektrike nga centralet me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.
4. Central elektrik do të thotë një tërësi godinash me disa impiante të caktuara të cilët kanë si destinacion bazë gjenerimin e energjisë elektrike.
5. OSSH është personi i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar aktualisht pjesë e KESH sh.a.

KAPITULLI I DYTË
HYRJA NË RRJET

Neni 5
Kërkesa për hyrjen në rrjet

Çdo kërkesë nga një aplikues për hyrjen në rrjet të centraleve të rinj të prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet konform rregullave të parashikuara në Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes.

Neni 6
Hyrja në rrjet

1. OSSH-ja do të shqyrtojë dhe marrë vendim për miratimin e pikës së lidhjes në rrjet të centralit elektrik brenda 30 ditëve nga marrja e një aplikimi të rregullt.
2. Pas miratimit të pikës së lidhjes në rrjet të centralit elektrik, OSSH-ja do të realizojë hyrjen në rrjet të centralit elektrik jo më vonë se 45 ditë pas njoftimit me shkrim në OSSH nga i licencuari për përfundimin e të gjitha punimeve në central.

KAPITULLI I TRETË
DISPOZITA FINALE

Neni 7
Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.595, datë 1.10.2007

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TELE JONI”
SUBJEKTIT: “TELE JONI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “TELE JONI” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën Himarë-Sarandë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.596, datë 1.10.2007

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT
VENDOR “TV PËRMETI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “TV Përmeti” sh.p.k. për televisionin privat vendor “TV Përmeti”, me nr.licence 082/TVL, për prefekturën e Gjirokastrës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohen departamenti teknik, departamenti ekonomik dhe departamenti juridik dhe i licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.597, datë 1.10.2007

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV INFO SHKODRA”
SUBJEKTIT FIZIK: LAIDAN DANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat

në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat vendor subjektin Laidan Dani, televizioni privat vendor “TV INFO SHKODRA”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte:

a) Garancia bankare.

2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.598, datë 1.10.2007

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV PARMA-SARALB”
SUBJEKTIT: “PARMA-SARALB” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat vendor subjektin “Parma-Saralb” sh.p.k., televizioni privat vendor “TV Parma- Saralb”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin:

a) Garancia bankare;

b) Vërtetimi i zyrës së regjistrimit tregtar;

c) Deklarata e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura.

2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.599, datë 1.10.2007

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE
“RADIO KISS”
SUBJEKTIT: KISS SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos licençojë për transmetim radiofonik privat vendor subjektin KISS sh.p.k., radio private vendore “Radio Kiss”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin:

- a) Garancia bankare;
- b) Vërtetimi i zyrës së regjistrimit tregtar;
- c) Deklarata e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura.

2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.605, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO SCORPION”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.028/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Scorpion” sh.p.k.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.606, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO MUZIKA JONË”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.054/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Muzika Jonë” sh.p.k.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 16.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.607, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“VAL’ E KALTËR”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.005/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Val’ e Kaltër”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.608, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO RASH”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.025/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “EDISUD Radio-TV” sh.p.k.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.609, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO ENERGY”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.051/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “NRG MULTIMEDIA” sh.p.k.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 16.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.610, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO ALPO”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.020/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin fizik Aristotel Petro.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.611, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO TOP ALBANIA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.01/FMK, të rinovojë për një afat të ri 6-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Top Albania” sh.a.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.612, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“RADIO KLEA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.057/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin fizik Taulant Pilavi.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 8.4.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.613, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“NEWS 24 TV”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.056/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike subjektin televiziv privat vendor “NEWS 24 TV”.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 15.5.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.614, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV MARGIT”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.057/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike subjektin televiziv privat vendor “TV Margit”.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 15.5.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.615, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV SUPERSONIC”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.055/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike subjektin televiziv privat vendor “TV Supersonic”.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 15.5.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.622, datë 1.10.2007

MBI SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR “RADIO MAGIC”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Frano Kulli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Gent Ibrahim	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence, të paraqitur nga subjekti radiofonik “Radio Magic”.

Baza ligjore: Neni 7, pika 21 dhe neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.158, datë 30.7.2003 ka licencuar personin fizik z.Kujtim Hasani për radion private vendore “Radio Magic”, me nr.licence 043/FML, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik për një periudhë prej 3 vjetësh.

Me vendimet nr.576 dhe nr.588, datë 27.4.2007, KKRT-ja ka vendosur të bëjë paraprakisht të pavlefshme licencën për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Magic”, pasi në përfundim të afatit të licencës, ky subjekt jo vetëm nuk paraqiti interes për rinovimin e licencës, por në të njëjtën kohë nuk kishte shlyer pagesën vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet radiotelevizive për vitin 2006.

Sipas pikës 2 të vendimeve të sipërcituara të KKRT-së, subjekti “Radio Magic” kishte të drejtë, që brenda një afati prej 30 ditësh të jepte mendimin e tij në lidhje me këto vendime.

Nëpërmjet shkresës së datës 14.5.2007, z.Kujtim Hasani ka depozituar kërkesën për rinovimin e licencës sipas arsyetimit si më poshtë vijon:

“...Jam shumë dakord për vendimin që morët kundrejt “Radios Magic”, sidomos për interesimin tim dhe ripërtëritjen e licencës në kohën e duhur, si dhe pagesat për vitet 2005-2006. Pretendimet e mia janë shumë domethënëse, sepse në kohët që unë nuk jam paraqitur te ju për rinovimin dhe për pagesat e prapambetura kanë qenë pak si të pamundura. Arsyeja e kësaj ka qenë impenjimi im për të bashkëpunuar me gjykatën e rrethit Kavajë për dhunimin që i është bërë “Radio Magic” dhe për arsye hetimi kam qenë tepër i mbyllur me këtë çështje, sipas tyre duhet të isha në çdo kohë që të më kërkonte gjykata për çështjet e dhunimit të “Radios Magic” nga disa persona që asnjëherë nuk gjeti zgjidhje. Përsa i përket pagesave jam dakord me ju në atë pikë, pasi më vonë unë i bëra ato, detyrimet që më takonin dhe nuk jam më debitor karshi jush. Do të dëshiroja që kjo arsyeja ime të merret në konsideratë nga ana juaj. Me respektin më të madh për ju dhe stafin e KKRT-së dëshiroj që kjo kërkesë të merret parasysh nga ana juaj. Ju kërkoj ndjesë për vonesën time për rinovimin e licencës dhe detyrimet. Do të jem i përpiktë me ju...”

KKRT-ja vëren gjithashtu se bashkëlidhur kërkesës së mësipërme, z.Kujtim Hasani ka depozituar edhe dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës për “Radio Magic”, nga i cili rezulton se:

- Në dokumentacionin ligjor mungojnë deklaratat noteriale, nëpërmjet të cilës deklarohet se

pronari nuk zotëron licencë të mëparshme për transmetim televiziv vendor, si dhe që nuk ka aksione në një shoqëri televizive ose radio kombëtare, si dhe deklarata mbi vërtetësinë e të dhënave.

- Ky subjekt nuk ka paraqitur bordin drejtues, kontratat e punës me punonjësit në radio, si dhe listëpagesat në sigurimet shoqërore.

- Subjekti nuk ka paraqitur bllokskemën principiale të funksionimit të transmetimit, bllokskemën e studios së transmetimit, listën e pajisjeve për riprodhimin transmetimin e programeve. Në projekt nuk specifikohen masat për sigurimin e një autonomie të kufizuar nga rrjeti elektrik për të garantuar vazhdimësinë e transmetimeve dhe nuk identifikohet autori i projektit teknik.

- Subjekti nuk ka depozituar të dhënat ekonomike e financiare për periudhën e licencimit sipas kërkesës së nenit 48 të ligjit. Dokumentacioni për vlerësimin e aseteve nuk është i plotë, nuk është vërtetuar nga ekspertë kontabël të autorizuar. Parashikimi i planit ekonomiko-financiar i paraqitur nuk është i plotë dhe nuk ka analizë të treguesve ekonomikë e financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve. Nuk ka paguar detyrimin për përpunimin e dokumentacionit për rilicencim në shumën 10.000 lekë.

- Subjekti nuk ka paraqitur një pasqyrim të saktë dhe të hollësishëm të të dhënave për programin javor të transmetimit, si dhe përmbajtjen e disa prej programeve që do të realizohen dhe transmetohen. Vërehet gjithashtu një mospërputhje në përqindjen që do të zënë në strukturën programore emisionet e prodhuara vetë, e shprehur kjo në shifra të ndryshme, ndërsa lidhur me kushtin e përqindjes që do të ketë në programin javor pasqyrimi i realitetit lokal, kjo shifër është në 14% pa specifikuar programe që pasqyrojnë këtë realitet.

Në këto kushte, KKRT-ja vëren se dokumentacioni i aplikimit të subjektit radiofonik vendor “Radio Magic” nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 8 e vijim të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

Nga sa më sipër rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për radion vendore private “Radio Magic”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Magic”.
2. Licenca me nr.licence 043/FML bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM Nr.623, datë 1.10.2007

MBI SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR “RADIO PLANET”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Frano Kulli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Gent Ibrahimimi	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik “Radio Planet”.

Baza ligjore: Neni 7, pika 21 dhe neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

VËREN SE:

Në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, subjekti radiofonik vendor privat “Radio Planet”, ka paraqitur dosjen e aplikimit për rinovimin e licencës.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi tërësor i dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se subjekti “Radio Planet” nuk ka paraqitur:

1. Deklaratën mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.
2. Të dhënat teknike të transmetuesit, si dhe bllokskemën principiale të funksionimit të transmetimit.
3. Nuk ka paguar detyrimet financiare, pagesën e licencës në shumën prej 57 300 lekësh për vitet 2005 dhe 2006 dhe taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve me një detyrim prej 96 000 lekësh për vitet 2005-2006.
4. Dokumentacioni për vlerësimin e aseteve nuk është i plotë, nuk është i vërtetuar nga ekspert kontabël të autorizuar.
5. Parashikimi i planit ekonomiko-financiar i paraqitur në dosje nuk është i plotë, mungon analiza e treguesve ekonomik e financiar.
6. Ka një mospërputhje midis të dhënave të paraqitura në formë tabelore dhe grafike, mungojnë të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me përmbajtjen e programeve, të dhënat për programet nuk janë paraqitur mirë estetikisht.
7. Mungojnë CV-të e bordit drejtues, kontratat me punonjësit e radios dhe formulari i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore janë paraqitur në formë të fotokopjuar.

Në këto kushte, KKRT-ja vëren se dokumentacioni i aplikimit të subjektit radiofonik vendor “Radio Planet” nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 8 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

Nga sa më sipër rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për radion vendore private “Radio Planet”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Planet".
2. Licenca me nr.licence 031/FML bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.625, datë 1.10.2007

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË DISA SUBJEKTEVE RADIOTELEVIZIVE
PRIVATE

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 33, pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjekteve radiotelevizive, që në mbarim të afatit të vlefshmërisë së licencës nuk kanë shfaqur interes për rinovimin e saj, si më poshtë:

Nr.	Emri i subjektit	Lloji i licencës
1.	TV Asparag	TV vendor
2.	Radio New Planet	Radio vendore
3.	Radio Real	Radio vendore

2. Subjekti sipas pikës 1 të këtij vendimi është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 16.10.2007
Doli nga shtypi më 16.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë